

V E N D I M
Nr.95, datë 27.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.6.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.58 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON PRENDI, përfaqësuar nga avokat Shefqet Muçi.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHEM, përfaqësuar nga zoti Arqile Lole.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.4, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr.32, datë 14.3.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.344, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Në kërkesë janë parashtruar në mënyrë të përmblëdhur këto shkaqe:

1. Të tri shkallët e gjyqësorit kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor sepse:

- Në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës dhe me dispozitat përkatëse procedurale-penale (nenet 4, 153 – 154 të Kodit të Procedurës Penale) gjykatat i kanë mbështetur vendimet vetëm në mendime personale të disa personave të thirrur me cilësinë e dëshmitarëve;

- Dëshmitë e pranuar nga gjykatat si “indirekte” janë të pavlefshme e të papërdorshme;

- Në kundërshtim me sa pranohej nga gjykatat në çështjen konkrete nuk janë vërtetuar indicje në ngarkim të Agron Prendit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në datën 6.8.1997, në afërsi të fshatit Dedaj të rrethit të Pukës është gjetur i vranë me armë zjarri viktimë Rifat Istrefi. Në lidhje me këtë ngjarje, ka filluar procedimi penal ndaj kërkuarit Agron Prendi, i cili me vendimin nr.04, datë 4.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë është deklaruar fajtor për vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje dhe, në bazë të neneve 76 e 278/II të Kodit Penal, është dënuar me 10 vjet heqje lirie. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.32, datë 14.3.2000 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.344, datë 5.10.2000.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të kërkuarit, si dhe çështjes në tërësi Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundim, se kërkesa duhet të rrëzohet me arsyetimin se në tërësi në të ngrihen shkaqe të cilat nuk kanë të bëjnë me realizimin e një procesi të rregullt gjyqësor në kuptim të neneve 42 e 131 të Kushtetutës e për pasojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe ajo e Apelit të Shkodrës kanë

pyetur, me cilësinë e dëshmitarit, një numër personash, të cilët, edhe pse nuk ishin dëshmitarë okularë, kanë shpjeguar rrethana të ndryshme, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat në lidhje me përcaktimin e fajësisë, motivet e kryerjes së krimit, si dhe shkallën e rrezikshmërisë së autorit. Në shqyrtimin e kësaj çështje nga këto gjykata, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi që në marrjen e vlerësimit të thënieve të personave të jenë shkelur parimet themelore të një procesi të rregullt ligjor. Po kështu, mbledhja e të dhënave nuk del që të jetë bërë në rrugë e mënyra të paligjshme, çka do të vinte ndesh edhe me nenin 32 pika 2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, ajo e Apelit Shkodër dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë thënie të një numri personash të pyetur me cilësinë e dëshmitarit i kanë vlerësuar si burim provash e indicjesh, të cilat në tërësinë e tyre u kanë shërbyer për të krijuar bindje për çështjen konkrete dhe për vendimet e marra. Nëse ky vlerësim është ose jo i drejtë e i bazuar, kjo është çështje e vetë gjykatave dhe nuk mund të përbëjë objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët e mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por kurrësi jo për mënyrën e vlerësimit të këtyre provave. Kjo për faktin se kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.

Në këto kushte kërkesa duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe nenet 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.